



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2513, datë 06.11.2014

Për

**Miratimin e dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin e dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al, e ndryshuar.**

**BAZA LIGJORE:**

- 1) Gërma k) dhe p) e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115 i Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**)
- 2) Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”, i ndryshuar.
- 3) Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

- 4) Vendimi i KD nr. Nr.2499, datë 17.09.2014, Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al, e ndryshuar.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Relacioni përkatës;
- Propozimi i hartuar nga grupi i punës
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Përfundimet e Këshillimit Publik,

si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

AKEP, sipas shkronjës k) të nenit 8 të ligjit nr.9918 është Autoriteti kompetent që administron domain ccTLD.al, nëndomain-et e tij , si dhe ENUM.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara përmirësojnë ndjeshëm si anën formale të Rregullores ashtu dhe rregullat në përmbajtje të saj, të cilat janë të nevojshme me qëllim reflektimin e disa ndryshimeve të domosdoshme në kuadër të masave për liberalizimin e mëtejshëm të rregullave për rregjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al

Dokumenti “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al”, e ndryshuar është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës duke patur parasysh dhe duke implementuar objektivat rregullator të AKEP.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë përfundimet e këshillimit publik, rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në nenin 114, dhe në nenin 115 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

## **V E N D O S:**

1. Miratimin e dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar,, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, si dhe qëndrimin e AKEP për çështjet e ngritura sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim të publikohet në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**



**A K E P**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

## Perfundimet e Keshillimit Publik

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al, edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar

Qëndrimi i Sipërmarrësve mbi ndryshimet në Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008, e ndryshuar dhe qëndrimi i AKEP mbi këto propozime është si më poshtë vijon:

**1. AKEP propozon që të Shfuqizohet gërma b) nenit 20.2**

*“Emrat përbëhen nga dy karaktere”;*

Regjistruesi **Albtelecom** është dakort me këtë propozim.

Sipërmarrësit **Studio Driar, Kemi Net, Web Host, ShqipëriaCom**, nuk janë shprehur në lidhje me këte pike

**2. AKEP propozon në lidhje me nenin 27 të Rregullores pas gërmës b) të shtohet një paragraf i ri e të gërmëzohet si c) me përmbajtje si më poshtë vijon: World Intellectual Property Organization -*WIPO*- (*Arbitration and Mediation Center*).  
(Referim sipas rregullave të përcaktuara në dokumentin bashkëlidhur).**

**Albtelecom** lidhur për sa më sipër, shpreh dakortësinë e tij por, propozon që pika “c” të jetë “Çdo formë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi sipas Qendrës së Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit të WIPO (World Intellectual Property Organization)

**Qëndrimi i AKEP :**

AKEP mendon se ndryshimi i propozuar në nenin 27 të Rregullores është i qartë dhe i përmbahet orientimit pra adresimit të palëve në World Intellectual Property Organization -**WIPO**- (**Arbitration and Mediation Center**), në referim të rregullave të parashikuara dhe të pranuar nga WIPO dhe AKEP të publikuara në Website e AKEP.

Sipërmarrësit **Studio Driar, Kemi Net, Web Host, ShqipëriaCom**, nuk janë shprehur në lidhje me këte pike

**3. AKEP propozon në Aneksin 1, pika 10 pas gërmës e) të shtohet një paragraf i ri me përmbajtje si: “Transferimi i një domain-i nga Regjistruesi AKEP te cilido regjistrues tjetër është pa pagesë dhe regjistruesi pritës nuk kreditohet dhe të gërmëzohet si 10 f) ndërkohë që gërma f) aktuale të bëhet g).**

**Albtelecom** shpreh dakortësinë e tij me këtë amendim.

Komenti i **Studio Driar, Kemi Net, Web Host, Shqipëria Com**, lidhur me këtë pikë:

*Pika 3 qe citon Aneksin 1, pika 10 të bëhet:*

*“Transferimi i një domain-i nga Regjistruesi AKEP te cilido regjistrues tjetër është pa pagesë dhe regjistruesi pritës nuk kreditohet kur akreditimi i tij është bërë më shumë se 1 vit më parë*

dhe të gërmëzohet si 10 f) ndërkohë që gërma f) aktuale të bëhet g) , duke nënkuptuar e madje cilësuar, se transferimet nga AKEP te regjistrarët që nuk kanë mbushur vitin si të akredituar do të tarifohet.

Ose të parashikohet një direktivë që mundëson rimbursimin nga ana e AKEP të krediteve që regjistrarët aktualë kanë paguar deri para hyrjes në fuqi të çmimeve të reja për transferime domenesh, ku të thuhet:

AKEP do të rimbursojë brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të çmimeve reja të gjithë Regjistrarët e akredituar me nga 2 kredite për çdo transfertë që u është tarifuar më parë nga AKEP (duke barazuar çmimin aktual).

### **Qendrimi i AKEP :**

Ky ndryshim është propozuar në mënyrë që të nxitet kalimi i domain-eve drejt regjistrarëve.

- 4. AKEP ka propozuar referuar Aneksit 1, Tabelës nr. 3 Pagesat për regjistrimin e domain c.c. TLD nga Regjistruesit, tek pika c) togfjalëshi “Çmimi i 1 (një) krediti për regjistruesit është 600 lekë” të zëvendësohet me “Çmimi i 1 (një) krediti për regjistruesit është 300 lekë”.**

**Albtelecom** vlerëson pozitivisht këtë iniciativë të AKEP, dhe mendon se kjo krijon një premisë të mirë për ofrim me çmime më të lira të shërbimeve të hostimit dhe rritjen e interesit për këto shërbime nga kompanitë e interesuara.

### **5. AKEP ka propozuar:**

Pas pikës c) të shtohet një pikë tjetër e cila të gërmëzohet pika d) me përmbajtje si më poshtë vijon:

#### **Tabela nr.3 Aneksi nr.1**

#### **Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD nga Regjistruesit**

Pagesat që Regjistruesit duhet të kryejnë në AKEP, të jenë si më poshtë:

a. Vlera e Akreditimit, për çdo subjekt që kërkon të veprojë si regjistrues 20 000 Lekë (pagesë e cila kryhet vetëm një herë të vetme);
b. Pagesa vjetore, që çdo subjekt i akredituar duhet të depozitojë për AKEP në mënyrë që të veprojë si Regjistrues 100 000 Lekë;
c. Cmimi i 1 (një) krediti për Regjistruesit është 300 lekë

d. Pagesa e regjistrimit të domain pranë AKEP është 5000 lekë për 5 (pesë) vjet.

Sipërmarresi **Albtelecom** në lidhje me propozimin për shtimin në Aneksin 1, Tabela nr.3 gërma **d**) gjykon se është e nevojshme të bëhen disa rregullime në tabelën nr.3 si rrjedhojë e përfshirjes/pasqyrimin tashmë edhe të një pagese e cila kryhet nga poseduesi i domain-it për llogari të AKEP (nuk ka qenë pasqyruar në rregulloren ekzistuese). Për sa më sipër nevojitet:

- Ose ndarja në 2 tabela me emërtimet “1. Pagesat për regjistrimin e domain cc.TLD nga Regjistruesit” dhe “2. Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD nga Poseduesit”; në këtë rast shtimi i propozuar i pikës “d” do të ishte pjesë e tabelës 2.
- Ose, në një tabelë të vetme, si ajo ekzistuese të bëhet saktësimi përkatës në emërtim psh ”**Tabela nr.3 Aneksi nr.1** “Pagesat për regjistrimin e domain cc. TLD nga Regjistruesit dhe Poseduesit e domain-ve” si dhe në pikën “d” të propozuar në dokumentin e këshillimit publik të specifikohet “Pagesa e regjistrimit të domain pranë AKEP nga Poseduesi i tij është 5000 lek për 5 (pesë) vjet.

#### **Qendrimi i AKEP :**

Pagesat e përcaktuara në Aneksi I, Tabela 3 janë të shprehura në mënyrë të qartë. Konkretisht gërma c) përcakton : çmimi i një krediti për Regjistruesit është 300 lekë që tregon saktë se kjo është pagese që kryhet nga Regjistruesit e akredituar. Termat Kredit/ Regjistrues janë të mirëpërcaktuara në Rregulloren. Pagesa e Regjistrimit të Domain pranë AKEP është 5000 leke për 5 (pese) vjet. Kjo pikë përcakton qartë se për të regjistruar një domain pranë AKEP nga çdo palë e interesuar jo nepermjet regjistruesve të tjerë është 5000 leke për 5 vjet.

Sipërmarresit **Studio Driar, Kemi Net, Web Host, Shqipëria Com** ka propozuar si më poshtë vijon:

Gërma a) Pika 5 që citon Tabelën 3, Aneksi 1, të amendohet me një tjetër kolonë ku të shënohet:

“Çmimi i 1000 krediteve që duhen paguar për akreditim si regjistruar është 600.000 lekë”.

Ose të parashikohet një Direktivë që mundëson rimbursimin nga AKEP të Regjistrareve të akredituar deri tani me diferencën ndërmjet vlerës së 1000 krediteve për akreditim me çmimin e mëparshëm 600 lekë me vlerën e 1000 krediteve për akreditim me çmimin e ri 300 lekë.

## **Qendrimi i AKEP:**

Në lidhje me propozimin e parashikuar me sipër “ Çmimi i 1000 krediteve qe duhen paguar per akreditim si regjistrar eshte 600.000 lekë”.

Ose te parashikohet nje Direktive qe mundeson rimbursimin nga AKEP të Regjistrarëve te akredituar deri tani me diferencen ndermjet vleres se 1000 krediteve per akreditim me cmimin e meparshe 600 leke me vleren e 1000 krediteve per akreditim me cmimin e ri 300 leke.

Propozimi është i papranueshëm për faktin se çmimi në fuqi është përlllogaritur me situatën tregut dhe dhe ka qenë plotësisht i justifikuar.

Ndryshimi i menduar është rezultat i zhvillimeve positive dhe i mundësive të reja që ka krijuar tregu. Për këtë arsye nuk mund të parashikohet praktika e rimbursimit dhe nuk mund të aplikohet në rastin konkret pasi në llogaritjen e vlerave te sipërcituara nuk janë konstatuar shkelje, por ka qenë i balancuar në funksion të kerkesë - ofertës.

Ndryshimi i tarifës në ulje është në funksion të gjëndjes aktuale të tregut me tendencë përmirësimin e tij. Amendimet e Rregullores ekzistuese marrin fuqi ligjore nga data e miratimit të tyre në K.D. dhe efektet fillojnë nga data e miratimit e në vijim.

Në lidhje me pikën 2. Për të lehtësuar procedurat e regjistrimit të domaineve, do të dëshironim që aktivizimi i domeneve .al të bëhej menjëherë, **duke shmangur aprovimin manual nga personeli i AKEP.** Duke kuptuar nevojën e filtrimit të domaineve të palejueshme, shprehim pozitivitetin tonë për funksionimin e deritanishëm të listes së domaineve të bllokuara. Për çdo rast AKEP të ruaje te drejten e bllokimit te çdo domain që do e cilesojë si të palejueshem, e që më tej duhet ta shtojë në listën e domeneve të palejuara.

## **Qendrimi i AKEP :**

Në lidhje me këtë propozim edhe pse jashtë objektit të dokumentit të Këshillimit Publik , AKEP sqaron: Bazuar në gërmën k) të nenit 8 ligji 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë , AKEP administron domain C.C TLD .al dhe nëndomain e tij si dhe ENUM. Si rrjedhojë aprovimi manual nga personeli i AKEP për aktivizimin e domeneve është një kompetencë e bazuar ligjërisht.

## **Konkluzione të Grupit të Punës:**

Sipërmarrësit parimisht janë dakort për këto ndërhyrje në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008, e ndryshuar .

Grupi i Punës pasi mori në konsideratë komentet e palëve të interesuara, vlerëson se përgjithësisht sipërmarrësit janë dakort me propozimet e AKEP për ndryshimet në Rregullore të cilat i shërbejnë qëllimit të përmirësimin të kuadrit rregullator për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al” .

## **Për sa më sipër grupi i punës i propozon Këshillit Drejtues të AKEP:**



1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008, “Për Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al” e ndryshuar, e ndryshuar;
2. Publikimin e mendimeve dhe komenteve të palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur